



Prishtinë: 18.07.2012

Kodi i ZRRE-së: V_422_2012

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK_V_774_04_12

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kreut IV, nenit 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
4. Vendimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_774_04_12**; dhe
5. Ankesën e KEK-ut me datë 08.05.2012.

Në mbledhjen e mbajtur më 18 korrik 2012 nxorri këtë:

VENDIM

- I **REFUZOHET** ankesa e KEK-ut ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin Jakup Berisha (shifra në KEK: DPR - 90034684), nga Prishtina, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK_V_774_04_12 i datës 24.04.2012.

Arsyetim

Punëtorët e autorizuar të KEK-ut për ndërrim njehsori me datë 13.01.2008 kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit dhe kanë larguar nga matja njehsorin elektrik nr. 34228729 dhe kanë vendosur për matje njehsorin e vet elektrik nr. 40861877.

Pas ndërrimit të njehsorit elektrik nga punëtorët e autorizuar të KEK-ut dhe dërgimit në qendrën e kalibrimit, punëtorët e autorizuar të qendrës së kalibrimit, kanë bërë kontrollimin detal të njehsorit elektrik nr. 34228729, ku është konstatuar se njehsori elektrik vulat (bllombat) shtetërore i ka të falsifikuara, nga ana e jashtme dëmtime tjera nuk ka si dhe numëruesi i njehsorit është i manipuluar.

Me datë 29.07.2008 Departamenti i Faturimit në KEK e ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar me anë të faturës DPR08HP06371 në vlerë prej 2,118.99€.

Pas ngarkesës së KEK-ut për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike në vlerë prej 2,118.99€, konsumatori ka parashtruar ankesë në KEK. Departamenti për konsumator në KEK ka shqyrtuar lëndën e konsumatorit ku edhe ka refuzuar ankesën e tij. Konsumatori pas marrjes së përgjigjës nga ana e KEK-ut, brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE me të cilin ka kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike.

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve ka bërë shqyrtimin e ankesës së konsumatorit dhe me datë 25.04.2012 ka nxjerr vendim duke **aprovuar** ankesën e konsumatorit dhe duke kërkuar nga KEK-



u që të shkarkoj konsumatorin nga fatura e shfrytëzimit të paautorizuar (rikthimit të humbjeve) DPR08HP06371 e datës 29.07.2008 në vlerë 2,118.99 €.

Pas marrjes së vendimit të DMK-së, me datë 08.05.2012 KEK-u ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRRE-së ndaj këtij vendimi, me të cilën ka kundërshtuar pjesëshëm vendimin e DMK-së nr. ZRRE/DMK_V_774_04_12 të datës 25.04.2012, dhe njëherit ka propozuar që aprovohet kundërshtimi i KEK-ut dhe borxhi i theksuar më sipër të ngelet kontest deri në përfundimin e të gjitha procedurave ligjore.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 18 korrik 2012 ka analizuar dëshmitë e paraqitur nga ana e KEK-ut, përkatësisht bazën e kundërshtimit procesverbalin e kalibrimit.

Gjatë analizës së lëndës së konsumatorit Bordi ka vërejtur se gjatë ndërrimit të njehsorit elektrik të konsumatorit punëtorët e KEK-ut nuk kanë evidentuar ndonjë dëmtim apo dyshim në njehsorin elektrik nr. 34228729, por vetëm se kemi ndërrim njehsori nga i mekanik në atë elektronik sipas pilot projektit të bërë nga KEK-u.

Bordi i ZRRE-së ka analizuar edhe shpenzimin e energjisë elektrike me njehsor të vjetër dhe me njehsor të ri ka ndryshim, ku me njehsor të ri elektrik ka një zbritje të shpenzimit. Mesatarja e shpenzimit të energjisë elektrike me njehsor të vjetër për periudhën 04/2004 deri më 12/2007 është 300 kWh/muaj ndërsa me njehsor të ri për periudhën 01/2008 deri më 12/2011 është 221 kWh/muaj

Sa i përket kundërshtimit të KEK-ut në ankesë që të merret bazë vetëm procesverbali i kalibrimit për të anuluar pjesërisht vendimin e DMK-së, Bordi i ZRRE-së pas shqyrtimit të këtij procesverbali ka vlerësuar se konstatimet e bëra në procesverbalin e kalibrimit nuk kanë qenë bindëse për të vërtetuar atë çka është theksuar në procesverbal. Sipas nenit 8, paragrafi 8.3 i Procedurës për Identifikimin dhe Parandalimin e Shfrytëzimit të Paautorizuar të Energjisë elektrike theksohet se, konstatimet e parregullsisë funksionale të njehsorit elektrik të konstatuara në laboratorin e kalibrimit nuk mund të përdoren si provë e vetme meritore për ngarkimin e konsumatorit me faturën e rikthimit të energjisë së humbur.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 18.07.2012 ka analizuar ankesën e KEK-ut dhe vendimin e nxjerrë nga ana e DMK-së nr. ZRRE/DMK_V_774_04_12, dhe pas analizimit të hollësishëm të të gjitha dëshmive tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur në diapozitivin e këtij vendimi.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimin të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar